




**Republika e Kosovës**  
*Republika Kosovo - Republic of Kosovo*  
**Autoriteti i Konkurrencës**  
*Autoritet za Konkurenciju - Competition Authority*



Nr.38/24  
Prishtinë, më 08.04.2024

Komisioni i Autoritetit të Konkurrencës i Republikës së Kosovës në mbështetje të nenit 26, nenit 27, nenit 29, nenit 35, nenit 36 paragrafi 6 neni 39 si dhe neni 55 paragrafi 2 me nën paragrafin 2.4, i Ligjit Nr. 08/L-056 për Mbrojtjen e Konkurrencës, Ligji Nr. 05/L -031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, bazuar në kërkesë/propozim, paraqitur nga Hajriz Zabeli përfaqësues i ndërmarrjes “Europrinty” SH.P.K, kundër Shtëpisë Botuese “Dukagjini” në mbledhjen e mbajtur me datën 08.04.2024 merr këtë:

### KONKLUZION

Autoriteti gjatë shqyrtimit paraprak të hetimit të situatës në tregun relevant, bazuar në dispozitat e Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës, konstatojmë se nuk ka argumente për fillimin e Procedurës Hetimore ndaj Shtëpisë Botuese Dukagjini SH.P.K, sipas nenit 36 paragrafi 4 i Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës.

### Arsyetim

Autoriteti i Konkurrencës i Republikës së Kosovës, me datën 13.10.2023, me Nr. Prot. 483/23-01/H, ka pranuar propozim/kërkesën nga Hajriz Zabeli me adresë: Rr. Nak Berisha Nr.23 Prishtinë, përfaqësues i ndërmarrjes “Europrinty” Sh.p.k, kundër Shtëpisë Botuese Dukagjini SH.P.K, me adresë: Rr. Hajdar Dushi Nr. 27 Prishtinë.

#### **Pretendimet e paraqitësit të iniciativës:**

Shtëpia Botuese “Dukagjini”, ka shkelur ligjin e konkurrencës duke operuar me çmime tejet të larta në treg, këtë e dëshmojnë çmimet sipas kontratës me MASHT dhe me institucione të tjera.

Të dhënat për produktin/shërbimet; p.sh:

1. Libri i klasës – Ditari parashkollor - (9-5 vjeç) – çmimi 15.00 euro - çmimi real.....
2. Libri i klasës – Ditari parashkollor - çmimi 15.00 euro - çmimi real.....
3. Libri i klasës – Ditari parashkollor (1-2) - çmimi 15 euro – çmimi real ....
4. Libri i klasës – Ditari parashkollor (3.4.5) - çmimi 15 euro – çmimi real
5. Libri i klasës – Ditari SHMU 6-9 - çmimi 15 euro – çmimi real....
6. Libri i klasës – Ditari i Gjimnazit - çmimi 15 euro – çmimi real....
7. Libri i klasës – Ditari IAAP - çmimi 15 euro - çmimi real....

8. Libri i klasës – Ditari i Gjinnazit matematikor - çmimi 15 euro – çmimi real ...
9. Libri i klasës – Ditari individual çmimi 15 euro – çmimi real....
10. Libri i klasës – Ditari Shkolla e Ulët e muzikës – çmimi 15 euro – çmimi real...
11. Libri i klasës – Ditari Shkolla e mesme e lartë e muzikës – çmimi 15 euro – çmimi real....
12. Libri amë – Fillor 1-5 (copë) – çmimi 20.00 euro – çmimi real....
13. Libri amë – SHMU (copë) çmimi 20.00 euro – çmimi real....
14. Libri amë – Gjinnaz (copë) çmimi 20.00 euro – çmimi real....
15. Libri amë – Shmp - çmimi 20.00 euro – çmimi real....
16. Libri për regjistrimin e fëmijëve në klasë të parë copë – çmimi 20.00 euro real .....
17. Librezat e nxënësve – Fillore 1-5 – çmimi 3.50 euro – çmimi real ....
18. Librezat e nxënësve - SHMU 6-9 – çmimi 3.50 euro – çmimi real....
19. Librezat e nxënësve - Muzikore 1-8 - çmimi 3.50 euro- çmimi real....
20. Diploma e Gjinnazit – çmimi - 1.00 euro – çmimi real....
21. Diploma SHMP - çmimi 1.00 euro – çmimi real....
22. Certifikata e profesionit – çmimi 0.80 euro – çmimi real....
23. Certifikata e profesionit PI - çmimi 0.80 euro çmimi real....
24. Certifikata e Maturës Shtetërore – çmimi 0.80euro – çmimi real....

Këto lloj të kontratave, siç është kjo në mes të Autoritetit Kontraktues “Ministria e Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë-MASHT” dhe Shtëpisë Botuese “Dukagjini” kanë sjellë vetëm çmime të fryra dhe ulje të kualitetit të produkteve ose shërbimeve dhe zbehin fuqinë e ndërmarreve duke i shkaktuar kështu dëme ekonomike, veçanërisht konsumatorëve. Për shkak të dëmeve të shumta që mund të shkaktojnë marrëveshjet të tilla.

## TREGU PËRKATËS APO RELEVANT

**Tregu gjeografik** - duke iu referuar nenit 4, 6 dhe 7 të Udhëzimit Administrativ për përcaktimin e tregut përkatës Nr. 01/2023, bazuar në analizën e këtij rasti, tregu gjeografik do të konsiderohet territori i Republikës së Kosovës.

**Tregu i produktit** - Dokumentet shkollorë që botohen për të gjitha nivelet e arsimit parauniversitar.

## Përshkrimi i Gjendjes Faktike të rastit

Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit, me datën 15 maj 2023, duke u bazuar në Udhëzimin Administrativ ( MASHTI) Nr.08/2022 për Dokumentacionin Shkollor në Arsimin Parauniversitar dhe vendimin nr.2-880, dt.11.05.2023 për caktimin e kushteve dhe kriterëve për botimin e dokumentacionit shkollor parauniversitar, kishte shpallur konkurs për botimin e dokumentacionit shkollor.

Dokumentet shkollorë të cilat duhet të botohen për të gjitha nivelet e arsimit parauniversitar ishin:

- Libri i klasës
- Libri amë;
- Libri për regjistrimin e nxënësve në klasë të parë;
- Dëftesa;



- Libreza e nxënësit;
- Diploma;
- Certifikata e profesionit;
- Certifikata e Maturës Shtetërore;
- Regjistri i diplomave të lëshuara;
- Regjistri i certifikatave të Maturës Shtetërore;

Shtypshkronja "Dukagjini" me vendim të sekretares së përgjithshme të Ministrisë së Arsimit ishte shpallur fituese e konkursit të datës 15 maj 2023.

Vendimi i sekretares ishte i bazuar në legjislacionin që e rregullon këtë fushë dhe në procesverbalin e Komisionit për përzgjedhjen e botuesit të dokumentacionit shkollor për të gjitha nivelet e arsimit parauniversitar në Republikën e Kosovës.

Pas përfundimit të këtij procesi, Drejtoritë e Arsimit janë njoftuar me fituesin e konkursit dhe procedurat e mëtejshme janë zhvilluar nga ana e tyre.

### **Analiza e Konkurrencës**

Autoriteti i Konkurrencës, angazhohet për të gjitha format e parandalimit, kufizimit ose keqpërdorimit të konkurrencës (Abuzimit me Pozitën Dominuese, Marrëveshjeve të Ndaluar, Praktikave të Bashkërenduara dhe Realizimit të Përqendrimeve të Paligjshme) nga ndërmarrjet ekonomike private apo publike, por edhe nga kufizimet e shkaktuara nga administrata shtetërore dhe entet rregullatore në territorin e Republikës së Kosovës ose jashtë saj, nëse këto veprime kanë efekte në Kosovë.

Parimi themelor i ligjit dhe politikës së konkurrencës është të sigurojë qasje në treg të lirë për çdo ndërmarrje, e cila i plotëson kushtet për të konkurruar në atë treg në interes të përdoruesve të shërbimeve dhe të mund të konkurrojnë me çmim dhe cilësi.

Objektivi kryesor i politikës së konkurrencës është ruajtja e procesit konkurrues dhe nxitja e konkurrencës efektive në treg. Ruajtja ose nxitja e konkurrencës efektive është e domosdoshme, duke pasur parasysh kufizimet që sektori privat apo ai shtetëror/publik mund t'i bëjnë konkurrencës. Prandaj ligji i konkurrencës ndalon marrëveshjet për fiksimin e çmimit, abuzimin me pozitë dominuese, si dhe përqendrimet që rrezikojnë të krijojnë një pozitë dominuese në treg.

Autoriteti konsideron se, në rastet kur ligjet e sektorit përkatës parashikojnë marrjen e masave të posaçme, si kontrolli i çmimeve ose aksesit në infrastrukture fizike, organet publike/rregullatorët sektoriale kanë detyrën dhe përgjegjësinë kryesore për të mbikëqyrur këta parametra të konkurrencës.

Gjithashtu, ligji formal që rregullon një sektor të caktuar duhet të parashikojë organin kompetent, të shprehë qartë që ky i fundit zotëron një kompetencë për caktimin ose miratimin e çmimeve, si dhe rastet në të cilat caktohet çmimi. Gjithashtu, përcaktohet se ky organ duhet të ushtrojë kompetencën, domethënë duhet të ketë marrë një vendim për rastin konkret.

Zhvillimi i ankandëve publike jep mundësi për transparencë dhe konkurrencë në procesin e përzgjedhjes, që lejon përdorimin efikas dhe efektiv të fondeve publike. Këto parime janë vendosur në shumicën e ligjeve moderne të prokurimit publik dhe duhet të sigurohen nga autoritetet kontraktore. Konkurrenca efektive mund të rritet nëse një numër i mjaftueshëm

ofertuesish të besueshëm janë në gjendje t'i përgjigjen ftesës për tender/ankand dhe të kenë një nxitje për të konkurruar për kontratën. Numri i ofertuesve varet shumë nga mënyra se si janë hartuar kushtet e ankandit publik.

Meqenëse autoritetet kontraktuese duhet të stimulojnë konkurrencën midis furnitorëve potencialë për të marrë vlerën më të mirë për parandë, ato në përgjithësi duhet të hartojnë kushtet e konkursit /tenderit në një mënyrë që inkurajon konkurrencën dhe lejon shumë furnizues të marrin pjesë dhe të konkurrojnë në baza të barabarta. Kjo zakonisht çon në çmime më të ulëta ose produkte ose shërbime me cilësi më të mirë.

Nga ana tjetër, nëse kushtet e konkursit apo tenderit janë përshtatur qëllimisht për të përjashtuar furnizuesit e tjerë të mundshëm dhe për të favorizuar një furnizues specifik, kjo jo vetëm çon në çmime më të larta, por mund të jetë edhe shkelje e ligjit të prokurimit publik.

Autoriteti konsideron se çmimi i ndërmarrjes Dukagjini, me MASHT ishte transparent, për faktin se e njëjta ishte shpallur fituese e konkursit të datës 15 maj 2023, sipas Ligjit nr. 04/L-032 për Arsimin Parauniversitar në Republikën e Kosovës, Udhëzimin Administrativ të MASHT-it Nr.08/2022 për Dokumentacionin Shkollor në Arsimin Parauniversitar, si dhe vendimin nr.2-880, dt.11.05.2023 për caktimin e kushteve dhe kriterëve për botimin e dokumentacionit shkollor parauniversitar. MASHT kishte pasur mundësi zgjedhje te kompanitë tjera, të cilat shesin dokumentet shkollore që botohen për të gjitha nivelet e arsimit parauniversitar dhe se oferta e Shtëpisë Botuese “Dukagjini”, ishte konsideruar ekonomikisht më e favorshme, nga autoriteti kontraktues.

Autoriteti në rastin konkret, nuk është kompetent për zbatimin e ligjeve të veçanta, por aspekti ligjor dhe rregullativ është në kompetencë të institucioneve tjera ligjore, e në këtë rast Ministrisë së Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë.

Nga sa më lartë, Komisioni i Autoritetit duke u bazuar në nenin 55 paragrafi 2 nën paragrafi 2.4 i Ligjit Nr. 08/L-056 për Mbrojtjen e Konkurrencës, u vendos si në dispozitiv të këtij Konkluzioni.

Obligohet Sekretariati që të kujdeset për zbatimin e këtij konkluzioni.

Ky konkluzion, hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga ana Komisionit.

## AUTORITETI I KONKURRENCËS

### Komisioni

**Neime Binaku - Isufi**

Kryetare



**Kaltrina Sela**  
Nënkryetare



**Florent Mehmeti**  
Anëtar



**Nafije Osdautaj**  
Anëtare



**Salihe Gashi Loku**  
Anëtare



Autoriteti i Konkurrencës

Adresa: Rr. Migjeni nr. 21,10000 Prishtinë. Kati i VI, zyra Nr.1  
Tel: +383 /0/ 38 200 109 82 E-mail: [info.konkurrenca@rks-gov.net](mailto:info.konkurrenca@rks-gov.net)

**Këshilla juridike:** Kundër këtij konkluzioni nuk është e lejuar ankesa, por pala me padi mund të iniciojë konflikt administrativ pranë Gjykatës kompetente për çështje administrative në afat prej 30 ditësh, nga data kur pala është njoftuar për aktin administrativ.

Me këtë KONKLuzion të njoftohen:

- Paraqitësi i Iniciativës
- Publikohet në web faqen e Autoritetit
- Arkiva